



AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax:+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202003056/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda : *Rekomandojmë marrjen e masave të nevojshme, për përballimin e kostove financiare të sigurimit të barrierave mbrojtëse (maskave) ndaj përhapjes së COVID-19, për pjesëtarët e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.*

Drejtuar : Bashkisë Tiranë
Bashkisë Belsh
Bashkisë Berat
Bashkisë Bulqizë
Bashkisë Cërrik
Bashkisë Delvinë
Bashkisë Devoll
Bashkisë Dibër
Bashkisë Divjakë
Bashkisë Dropull
Bashkisë Durrës
Bashkisë Elbasan
Bashkisë Fier
Bashkisë Finiq
Bashkisë Fushë-Arrëz
Bashkisë Gjirokastrë
Bashkisë Gramsh
Bashkisë Has
Bashkisë Himarë
Bashkisë Kamëz

Bashkisë Kavajë
Bashkisë Klos
Drejtuar : Bashkisë Kolonjë
Bashkisë Konispol
Bashkisë Korçë
Bashkië Krujë
Bashkisë Kukës
Bashkisë Kurbin
Bashkisë Kuçovë
Bashkisë Këlcyrë
Bashkisë Lezhë
Bashkisë Libohovë
Bashkisë Librazhd
Bashkisë Lushnje
Bashkisë Maliq
Bashkisë Mallakastër
Bashkisë Malësi e Madhe
Bashkisë Mat
Bashkisë Memaliaj
Bashkisë Mirditë
Bashkisë Patos
Bashkisë Peqin
Bashkisë Pogradec
Bashkisë Poliçan
Bashkisë Prrenjas
Bashkisë Pukë
Bashkisë Pustec
Bashkisë Përmet
Bashkisë Roskovec
Bashkisë Rrogozhinë
Bashkisë Sarandë
Bashkisë Selenicë
Bashkisë Shijak
Bashkisë Shkodër

Bashkisë Skrapar
Bashkisë Tepelenë
Bashkisë Tropojë
Bashkisë Ura Vajguore
Drejtuar : Bashkisë Vau i Dejës
Bashkisë Vlorë
Bashkisë Vorë

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të mandatit kushtetues, për parandalimin e shkeljes, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, në ndjekje të gjendjes së krijuar në vendin tonë nga pandemia Covid-19, dhe me një vëmendje të posaçme ndaj të drejtave të individëve dhe grupeve vulnerabël, apo komuniteteve në nevojë, po monitoron në vazhdimësi gjendjen e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane të vendosura në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe masat e marra për plotësimin e nevojave bazike të jetesës, në kushtet e përhapjes së infeksionit të Covid-19.

Që nga fillimi i kësaj pandemie me pasoja konkrete edhe për vendin tonë, autoritetet shtetërore përgjegjëse kanë nxjerrë një sërë aktesh me karakter normativ, të cilat kanë synuar dhe synojnë marrjen e masave për minimizimin e përhapjes së infeksionit të Covid-19, të shoqëruara në disa raste me masa të tjera me karakter mbështetës financiar, për kategori të caktuara subjektsh dhe individësh.

Së fundmi, për shkak të së ashtëquajturës “valë e dytë” e pandemisë së Covid-19, pas një lehtësimit të ndodhur pak muaj më parë, masat parandaluese të minimizimit të përhapjes së këtij infeksioni viral janë shtuar, duke vendosur së fundmi detyrimin e çdo personi (me përjashtimet përkatëse) brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, që të përdorë barrierat mbrojtëse (maskat mbrojtëse për pjesën e fytyrës që mbulon hundën dhe gojën), edhe në ambientet e hapura publike.

Më konkretisht, në nenin 1, të Aktit Normativ nr.32 datë 12.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për një ndryshim në Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave, nr.3 datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”,” i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

“Pika 23, e nenit 3, të Aktit Normativ nr.3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

23. Barriera mbrojtëse (maska) është e detyrueshme të përdoret jashtë shtëpisë nga çdo individ. Individët, të cilët përjashtohen nga ky rregull, përcaktohen në udhëzimin e Institutit të Shëndetit Publik. Instituti i Shëndetit Publik nxjerr udhëzimin përkatës për mënyrën e përdorimit të barrierës mbrojtëse (maskës), jashtë shtëpisë”.

Shkelja e detyrimit për përdorimin e maskës jashtë shtëpisë, dënohet administrativisht me gjobë, e aplikuar si një masë ndëshkimi administrativ rast pas rasti, sikurse parashikohet më tej në nenin 1, të Aktit Normativ nr.32 datë 12.10.2020, të Këshillit të Ministrave, ku thuhet shprehimisht se:

“Mospërdorimi i barrierës mbrojtëse (maskës), nga individët jashtë shtëpisë dënohet me gjobë në masën 3000 (tre mijë) lekë dhe, në rast përsëritjeje, në masën 5000 (pesë mijë) lekë. Të drejtën e dhënies së masës administrative për mospërdorimin e barrierës mbrojtëse (maskës) e

ka Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake, sipas modelit të gjobës së miratuar prej tyre. Ekzekutimi i masës administrative do të kryhet nëpërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, duke u bërë pjesë e faturave të energjisë elektrike.

Mënyra e ekzekutimit të masës administrative nëpërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për energjinë, ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë”.

Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë dhe i ka filluar efektet e tij, në datën 15.10.2020.

Në vijim të plotësimit të kësaj baze ligjore, me shkresën nr.1163/1 datë 13.10.2020, të Institutit të Shëndetit Publik, është nxjerrë Udhëzuesi “Mbi përdorimin e detyrueshëm të maskave në ambjentet jashtë shtëpisë”. Në këtë udhëzues theksohet dhe detajohet detyrimi për përdorimin e maskave mbrojtëse jashtë shtëpisë, mjete mbrojtëse këto të cilat mund të jenë kirurgjikale (një përdorimëshe), ose prej tekstili (shumëpërdorimëshe).

Në Udhëzues përcaktohet shprehimisht se, përdorimi i maskës mbrojtëse rekomandohet për individët në rastet si më poshtë vijon:

- Kur dalin nga shtëpia,
- Për fëmijët në moshën mbi 11 vjeç,
- Gjatë të gjithë ditës, gjatë të gjithë veprimtarisë jashtë banesës,
- Në çdo dyqan, supermarket apo aktivitet tregtar,
- Në të gjitha mjetet e transportit publik, dhe jo publik kur në të gjenden persona të tjerë përveç drejtuesit të automjetit,
- Edhe gjatë ecjes në rrugë,
- Gjatë qëndrimit në të gjitha vendet publike të hapura si park apo shesh,
- Gjatë gjithë aktivitetit të punës në zyra, të gjithë institucionet publike dhe jo publike, teatër, kinema, muze, biblioteka etj.
- Në hyrje dhe në dalje nga banesa dhe në ashensorë,
- Përpara dhe pas konsumit të ushqimit në bare dhe restorante,
- Në motoçikletë kur merr një person tjetër jo anëtar të familjes,
- Nëse jeni duke u kujdesur në shtëpi për një familjar me Covid-19,
- Në të gjitha institucionet fetare,
- Nga personat që e kanë kaluar SARS COV-2, për t'u mbrojtur nga shkaktarët e tjerë infektivë respiratorë,
- Në institucionet arsimore dhe ato të kujdesit shëndetësor sipas rekomandimeve të mëparshme.

Udhëzuesi përcakton në vazhdim edhe rastet situatat përjashtimore të përdorimit të barrierës mbrojtëse (maskës).

Detyrimi për të vendosur dhe mbajtur barrierën mbrojtëse (maskën), sipas përcaktimeve të Aktit Normativ nr.32 datë 12.10.2020, të Këshillit të Ministrave, në fakt veç parashikimeve të aspektit parandalues të përhapjes së infeksionit të Covid-19 dhe atij mbrojtës për shëndetin publik, passjell nga ana tjetër një kosto të shtuar dhe efektivisht jo të vogël për secilin qytetar, ndaj të cilit vendoset ky detyrim.

Kuptueshëm që, ky detyrim përfshin edhe individët me përkatësi në pakicat kombëtare Rome apo Egjiptiane, dhe në tërësi pjesëtarët e familjeve Rome dhe Egjiptiane, në të gjithë territorin e vendit, sipas përkatësisë territoriale administrative të njësive të vetëqeverisjes

vendore, në kushtet kur pjesa dërmuese e tyre kanë probleme dhe vështirësi të theksuara ekonomike.

Është koha të risjellim në vëmendjen tuaj faktin se, realiteti i përditshëm që shohim më sytë tanë na ka bërë të reflektojmë thellë dhe të kuptojmë se individët me përkatësi në pakicën kombëtare Rome dhe ata me përkatësi në pakicën kombëtare Egjiptiane, në një shumicë dërmuese të tyre, përfaqësojnë një grup vulnerabël dhe në risk, sikurse edhe disa kategori të tjera sociale në vendin tonë. Sistemi ynë social (ku përfshihen beneficatat që lidhen me strehimin, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimin e ndihmës ekonomike, apo edhe arsimimin, si problemet më kyçe, pa përjashtuar këtu punësimin, formimin profesional, kujdesin shëndetësor dhe çdo beneficë që sistemi ynë social, ua siguron qytetarëve të vet), formalisht i pranon këta individë, por faktikisht i përjashton ata duke u kthyer në një pengesë të pakalueshme burokratike dhe sinonim të një refuzimi të pashpallur social.

Individët dhe familjet e pakicave kombëtare Rome dhe Egjiptiane, ndër vite kanë vuajtur për shkak të privimit të tyre, për punësim, arsimim, mbrojtje sociale, etj. Gjendja e tyre aktuale si të pastrehë, të papunë dhe pa shërbime jetësore në çdo hap, rrit dhe përkeqëson edhe më tej gjendjen e këtyre komuniteteve, e të gjitha këto pasoja nuk çenojnë vetëm ato por sjellin efektin e tyre negativ në cilësinë e jetesës për të gjithë qytetarët shqiptarë. Gjendja paraqitet edhe më e rënduar tashmë, kur përjashtimet nga sistemi i ndihmës ekonomike të individëve, apo familjeve Rome dhe Egjiptiane, bashkëshoqërohen nga mungesa e regjistrimit të një pjese jo të vogël të tyre (kryesisht Rom), në regjistrat themelore të gjendjes civile, mungesa e punësimit, punësimi individual “në të zezë”, etj.

Në këtë problematikë të gjerë ekzistuese, masat e përgjithshme të marra për të parandaluar infeksionin e Covid-19, rezultojnë të jenë të pamundura për këto komunitete, duke i ekspozuar pjesëtarët e tyre drejt varfërisë ekstreme, e cila përshkallëzohet deri në mbijetesë.

Kostoja financiare e nevojshme që rrjedh nga detyrimi për zbatimin e masës, për vendosjen dhe mbajtjen e barrierës mbrojtëse (maskës), sipas përcaktimeve të Aktit Normativ nr.32 datë 12.10.2020, të Këshillit të Ministrave, si dhe të Udhëzuesit të Institutit të Shëndetit Publik, “Mbi përdorimin e detyrueshëm të maskave në ambientet jashtë shtëpisë”, rëndon më tepër gjendjen e këtyre individëve dhe familjeve të tyre, për të cilat kemi theksuar që në ditët e para të fillimit të pandemisë së Covid-19, se tashmë kanë më tepër nevojë për ndihmë konkrete dhe të vazhduar, jo vetëm në ushqime, dezinfektues dhe nevoja të tjera bazike jetese, por së fundmi edhe për përballimin e koston financiare të sigurimit dhe blerjes së barrierave mbrojtëse (maskave).

Pamundësia e këtyre individëve për të përballuar koston e blerjes të barrierave mbrojtëse (maskave), me qëllim përdorimin e tyre efektiv sipas detyrimeve ligjore në fuqi, i ngarkon ata realisht me një kosto të dyfishtë, duke i rënduar njëkohësisht, me koston fillestare të blerjes dhe sigurimit të maskave mbrojtëse, apo në vazhdim me ndëshkimin administrativ rast pas rasti, që do të vijë si shkak i mosvendosjes së maskave, për shkak të mospërballimit nga ana e tyre të koston së nevojshme të blerjes së maskave.

Nën një presion të tillë është e vështirë të mendosh për përballimin e një jetese normale, në kushtet kur shumica e këtyre individëve apo familjeve trajtohen me ndihmë ekonomike. Edhe më problematike paraqitet situata në kushtet kur një pjesë jo e vogël e individëve me përkatësi në

pakicat kombëtare Rome dhe Egjiptiane, janë të vetëpunësuar në veprimtari që kryhen në ambiente të hapura publike.¹

Kjo gjendje paraqitet e njëjtë në të gjithë vendin duke përbërë një tregues të qartë se, masat e marra nga ana e institucioneve përgjegjëse, rezultojnë të pamjaftueshme dhe jo proporcionale për të garantuar një jetesë normale për këto komunitete, brenda kushteve të ndërmarrjes së masave parandaluese për minimizimin e përhapjes së Covid-19. Është fakt se, Akti Normativ nr.32 datë 12.10.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për një ndryshim në Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave, nr.3 datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”,” i ndryshuar, nuk është shoqëruar me nxjerrjen e një akti nënligjor, ku të parashikohen masa me karakter mbështetës financiar, për kategori të caktuara subjektsh dhe individësh.

Sikurse kemi theksuar, kuadri ligjor në fuqi konsideron specifikisht të rëndësishme problematikën që lidhet me jetesën në tërësi të pakicës kombëtare Rome dhe asaj Egjiptiane, duke formuluar dhe miratuar strategji kombëtare, si dhe përgjegjësi konkrete për ndërmarrjen e masave pozitive për ndryshimin e kësaj situatë. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1072 datë 23.12.2015, ka miratuar dokumentin strategjik, “Plani Kombëtar i Veprimit për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020”, ku parashikohen një sërë masash për përmirësimin e kushteve të jetesës së këtyre minoriteteve dhe integrimin e tyre në shoqëri, në afat aplikimi afat shkurtër dhe afat mesëm.

Çështja bëhet edhe më sensitive, pasi kemi të bëjmë me trajtimin e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane dhe respektimit të të drejtave të tyre, si një element i theksuar qartë edhe në pesë prioritetet, që vendi ynë duhet të përmbushë në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Europian.

E megjithatë, situata aktuale kërkon një tjetër objektiv vlerësimi dhe ritëm shumë më të shpejtë, në masat dinamike që duhet të ndërmerren për komunitetet Rome dhe Egjiptiane në të gjithë vendin, kudo ato ndodhen.

Duke ndjekur nga afër dhe me shqetësim gjendjen e këtyre komuniteteve, Avokati i Popullit gjykon se, sot nevojitet një vëmendje e angazhim institucional i shtuar, për t’ju përgjigjur nevojave bazike të jetesës së këtyre komuniteteve, e konkretizuar me masa që ndikojnë drejtëpërdrejtë dhe që sigurojnë një standard të pranueshëm jetese në kushtet e pandemisë Covid-19, në vendin tonë. Në rekomandimet tona të mëparshme kemi nënvizuar se, ofrimi i ndihmës financiare shtesë, i mjeteve bazë të jetesës, garantimi i ofrimit të shërbimeve bazë sociale dhe aksesit në këto shërbime për këto komunitete, do të përbënin disa nga sugjerimet e institucionit të Avokatit të Popullit, drejtuar organeve të qeverisjes vendore, të cilat do të mundësonin përballimin dhe kapërcimin sa më denjësisht të kësaj situatë.

Tashmë, në kushtet e vendosjes së masave të reja parandaluese, për përhapjen e Covid-19, sugjerojmë si të nevojshme marrjen e masave të shtuara nga ana e organeve të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me funksionet e përcaktuara në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, për të siguruar ndihmesën dhe lehtësitë e nevojshme ndaj komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, për përballimin e kostos së blerjes së maskave mbrojtëse, apo të pajisjes së tyre në mënyrë të drejtëpërdrejtë me maska, nga ana e strukturave të organeve të vetëqeverisjes vendore.

¹ Sidomos në rastin e individëve që i përkasin pakicës kombëtare Rome, vetëpunësimi nëpërmjet mbledhjes së materialeve të riciklueshme në vendgrumbullimet e mbetjeve urbane është një alternativë e shfrytëzuar prej tyre, për të siguruar jetesën e përditëshme për veten dhe familjet.

Këto masa të reja duhet të vlerësohen si një kontribut i domosdoshëm që duhet të jepet ndaj këtyre komuniteteve për parandalimin e përhapjes së infeksionit të Covid -19 dhe ruajtjes së shëndetit të pjesëtarëve të tyre, por edhe si një kontribut më i gjerë që në efektin “zinxhir” të përhapjes së sëmundjes, ndikon drejtëpërdrejtë në ruajtjen e shëndetit publik, të popullsisë që jeton në njësinë territoriale administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Duke marrë në kohë masat e propozuara, do të jemi në gjendje të parandalojmë një situatë krejtësisht të pamëshueshme duke u gjendur me afër qytetarëve dhe nevojave të tyre, dhe nga ana tjetër kontribuojmë realisht në përmbushjen e detyrave të organeve të vetëqeverisjes vendore dhe në respekt të plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Avokati i Popullit rithekson edhe një herë qëndrimin e tij institucional se, askush nuk duhet të lihet prapa në këtë situatë të pazakontë, që kërkon ndërveprim, mbështetje dhe solidarizim shoqëror.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Vilma SHURDHA